

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CHB SERVICES” SHPK**

Sot, më datë 06/09/2022, ortaku i vetëm, si më poshtë:

- 1. Z. Qirjako Dorri**, atësia Klement, shtetas shqiptar, lindur më 05.06.2000 në Berat, dhe banues në Tiranë identifikuar me Letërnjoftimin ID me nr. 033586622, me nr. personal K00605073L, email: qdorri20@gmail.com.

Vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 1
DATA E THEMELIMIT**

Sot, më datë 06.09.2022, themeluesi vendosi të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“CHB SERVICES” SHPK**.

**NENI 2
FORMA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3
EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është **“CHB SERVICES” SHPK**.

**NENI 4
SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rr. “Robert Shvare”, Komuna e Parisit, Kompleksi “Niku Construction”, Shkalla nr.2, Ap.6/1, Kati 6, njësia administrative nr. 5, Tiranë, Shqipëri.



Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “**CHB SERVICES**” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Ofrimi i shërbimeve në fushën e shërbimeve IT (sistemeve të teknologjisë së informacionit) si dhe menaxhimi i serverave, konfigurimi i serverave, Helpdesk etj.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku i vetëm si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Qirjako Dorri	100 %	1	10.000 (Lekë)

Ky kapital është i përbërë nga 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8

ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “CHB SERVICES” SHPK do të jetë:

Z. Qirjako Dorri, atësia Klement, shtetas shqiptar, lindur më 05.06.2000 në Berat, dhe banues në Tiranë identifikuar me Letërnjoftimin ID me nr. 033586622, me nr. personal K00605073L, Email: qdorri20@gmail.com dhe nr. telefoni 0694085875.
Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9 DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.
Autorizohet Administratori Z. Qirjako Dorri për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**THEMELUES
QIRJAKO DORRI**

Qirjako Dorri 